

STATUTI

I

SHOQERISE ANONIME

KREU I

EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA

Neni 1

EMRI I SHOQERISE

1. Shoqeria emertohet **Kombinati Energjitik Elbasan sh.a.**Ne dokumentat.faturat, reklamata dhe botimet e nxjerra nga shoqeria,emri i saj do te ndiqet me inicialet **sh.a.**,nga numri i regjistrimit dhe selia e saj e regjistruar.
2. Shoqeria Kombinati Energjitik Elbasan sh.a eshte person juridik publik,jo-buxhetor shqiptar qe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas *nenit 68 te ligjit nr.9901,date 14.01.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"*, i azhornuar

Neni 2

OBJEKTI

1. Objekti i shoqerise eshte:
 - a) Demolim asetesh dhe te ardhura nga qeraja
2. Shoqeria,Brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi,do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthcrazi me objektin e saj.

Neni 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte pa afat te caktuar.Ky afat mund te ndryshohet nje qese me shume here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 4

SELIA

- 1.Selia e shoqerise eshte ne **Elbasan,Rajoni i Metalurgjise**,Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacioni ne fuqi,mund te hape si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj,qendra dhe perfaqesi apo filiale,dege dhe shoqeri te tjera,me vendim te Aksionerit.

KREU II

1 | Kombinati Energjitik sh.a Elbasa



Shefket
Kodurjella
Arif

STATUT I SHOQËRISË

“Kombinati Energjetik Elbasan” sh.p.k.

KREU I

EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1 EMRI I SHOQËRISË

1. Shoqëria emërtohet **Kombinati Energjetik Elbasan sh.a.** Në dokumentat, faturat, reklamat dhe botimet e nxjerra nga shoqëria, emri i saj do të ndiqet nga inicialet **sh.a.**, nga numri i regjistrimit dhe selia e saj e regjistruar.
2. Shoqëria Kombinati Energjetik Elbasan sh.a. është person juridik publik, jo-buxhetor shqiptar që ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas *nenit 68 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i azhornuar.*

Neni 2 OBJEKTI

1. Objekti i shoqërisë është:
 - a. Demolim asetesh dhe te ardhura nga qeraja
 2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.


Neni 4 SELIA

1. Selia e shoqërisë është në **Elbasan, Rajoni i Metalurgjise.** Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera, me vendim të Aksionerit.

KREU II

1

Drejtori
Kombinati Energjetik Elbasan sh.a.



KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

Neni 5 KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është **856.039.000 Lekë**, i përbërë nga 856.039 Aksione me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) Lekë secila. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht. Në shumën e kapitalit të shoqërisë nuk është përfshirë vlera e truallit, gjë që do të bëhet në një kohë të dytë përpara se shoqëria të privatizohet ose në momentin e privatizimit.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 deri 180 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
3. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zvogelohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 81 deri 186 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 6 AKSIONET

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Aksionet e kapitalit e të drejtat e lindura prej tyre mund t'i kalojnë Aksionareve apo të tretëve nëpërmjet:
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) Shitblerjes;
 - c) Trashëgimisë;
 - d) Dhurimit;
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.
3. Në rastin e kalimit të Aksioneve me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
4. Aksionet zotërohen në masën **100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipermarrjes** si përfaqësuese e pronarit shtet.
5. Pronësia dhe titulli mbi Aksionet do të rezultojë nga regjistrimi i emrit të pronarit në **Librin e Aksionerit**, që do të mbahet në selinë e shoqërisë, nën kujdesin e Administratorit.
6. Libri i Aksionerit do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - Numrin e Aksioneve të mbajtura nga Aksioneri;
 - Datën në të cilën Aksioneri fitoi pronësinë;
 - Emrin dhe adresën e Aksionerit;
 - Vlerën nominale të Aksioneve të mbajtura;
 - Detaje për çdo peng apo barrësim mbi Aksionet.
7. Aksioneri ka të drejtë të verifikojë regjistrimin e tij në Librin e Aksionerit dhe Administratori, në qoftë se është kërkuar me shkrim, do t'i sigurojë ndihmën e domosdoshme për këtë gjë.

KREU III

Qefto
Meadur
Sello
Qefto



ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE



Neni 7 ORGANI VENDIMARRËS

1. Organet drejtuese te Shoqerise:
 - a. Asambleja e Pergjithshme (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes)
 - b. Keshilli mbikqyres
 - c. Administratori i shoqerise

Neni 8 Keshilli Mbikqyres

1. Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare.
2. Anetaret e keshillit Mbikqyres emerohen nga:
 - 1/3 nga Ministria e Finances
 - 1/3 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes
 - 1/3 nga Ministria e Energjise dhe Industrise
3. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike.
4. Kohezgjatja e funksionit te anetareve te keshillit mbikqyres eshte 3 vjet, anetaret e keshillit jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit i cili i ka emeruar si anetare te keshillit mbikqyres per shkaqe te perligjura.

Neni 9 Kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh midis anetareve te tij nje kryetar i cili thotet mbledhjen e keshillit mbikqyres dhe drejtojne diskutimet. Kryetari zgjidhet per te gjithe kohen e mandatit te tij dhe eshte i rizgjedhshem.

Neni 10 MARRJA E VENDIMEVE TE KESHILLIT

1. Keshilli i Mbikqyres i Shoqerise mblidhet sa here e kerkon interesi i shoqerise me thirrjen e kryetarit.
2. Keshilli Mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhje dhe nenshkruset nga anetaret e keshillit pas cdo mbledhjeje.
3. Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga administratori i shoqerise dhe i jep ketij te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga administratori pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
4. Keshilli Mbikqyres emerone Administratorin e Pergjithshem si dhe lidh kontrate me te.
5. Administratori i Shoqerise i paraqet keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj raport mbi aktivitetin e shoqerise.
6. Keshilli Mbikqyres i propozon Asamblese se Aksionereve (ministrise) ndryshim e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesem, dhe afatgjate te shoqerise.



Drejtuar nga
Adriatik Isalli
Adriatik Isalli



Kuvendi i Shqipërisë

7. Si dhe çdo veprim tjetër në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
8. Të gjithë vendimet e marra në mbledhje duhet të regjistrohen në procesverbale sipas parashikimit të nenit 90 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshimeve që mund të pësojë në kohë.

Neni 11

Shpërblimi i anetareve të keshillit mbikqyres

Anetaret e keshillit mbikqyres shpërblehen në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 12

ADMINISTRIMI

1. Keshilli Mbikqyres emëron një **Administrator të Përgjithshëm**.
2. Shoqëria administrohet nga Administratori i Përgjithshëm.
3. Administratori i Përgjithshëm zgjidhet për një afat 3 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje, mbi baza kontratash të rinovueshme. Emërimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratori zgjidhet me kombësi shqiptare, nuk mund të ushtrojë veprimtarinë në më shumë se një shoqëri dhe nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç. Administratori mund të zgjidhet nga të punësuarit e rangut të lartë të shoqërisë, por edhe jashtë saj.
5. Administratori i Përgjithshëm ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nën-delegimit.
6. Emërimi dhe shpërblimi i Administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të keshillit Mbikqyres, në aktin e emërimit.
7. Në rast vdekje, dorëheqje, pushimi të çdo Administratori, pasardhësi që zë vendin e tij zgjidhet menjëherë nga Keshilli Mbikqyres me vendim të zakonshëm.
8. Mbas pranimit të emërimit të tyre, Administratori pranon me shkrim që marrëdhënia e tij me shoqërinë është e lidhur me bazë besimi dhe në lidhje me këtë vendim për t'i pushuar nga puna ata me anë të një vendimi, gjykohet si arsye legjitime dhe nuk kundërshtohet.

Neni 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT


1. Administratori i përmbahet me profesionalizëm të gjithë kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në nenet 14, 15, 17, 18, 95 – 98 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Administratori i propozon Keshillit Mbikqyres për :

Drejtori,
Keshilli Mbikqyres
Oguz



- a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë (Plan Biznesi);
 - b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së shoqërisë;
 - c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - d) Hapjen e veprimtarive ose njësisë të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë;
 - e) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërive sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera;
 - g) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata;
 - h) Strukturën e organizimit të shoqërisë;
 - i) Fillimi i një çështje gjyqësore ose zgjidhja e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është përfshirë shoqëria, sa i përket konflikteve ligjore të krijuara në kohën e administrimit të shoqërisë nga ish – ortakët ose kur një veprim i tillë dëmton dukshëm të drejtat e shoqërisë;
 - j) Si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e asamblesë së përgjithshme.
3. Administratori i Përgjithshëm ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.
 4. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit të Përgjithshëm kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm duhet të respektohen nga të tretët. Kompetencat e Administratorit që përfaqëson shoqërinë do të përfshijnë për këtë qëllim kompetencën që të nënshkruaj çeqe, urdhra, kontrata, nota zyrtare, drafte dhe dokumenta e instrumenta të tjerë në lidhje me aktivitetin e shoqërisë dhe të ekzekutojë çdo dokument që kërkon vulën e shoqërisë me përjashtim kur ekzekutimi i këtij dokumenti kërkohet ose lejohet ndryshe nga ligji të nënshkruhet ose të ekzekutohet ose me përjashtim kur nënshkrimi dhe ekzekutimi i tij do të delegohet qëllimisht me vendim të Asamblesë me vendim të zakonshëm të një zyrtar tjetër i shoqërisë.
 5. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori i Përgjithshëm ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
 6. Administratori i shoqërisë harton strukturën e shoqërisë, të cilën e miraton në Asamblesë të Përgjithshme.
 7. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore, të cilat miratohen nga Administratori i shoqërisë. Sa i përket Rregullores së Përgjithshme të funksionimit të shoqërisë, ajo miratohet nga Administratori i shoqërisë i cili kujdeset që ajo të jetë në përputhje me strukturën e miratuar nga Asambleja dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit. Megjithatë Administratori është i detyruar që të paraqesë një kopje të njehsuar me origjinalin të kësaj Rregulloreje Asamblesë së Përgjithshme, në ditën e fuqizimit të saj. Brenda 20 ditëve nga data e marrjes në dorëzim Asambleja ka mundësi të kundërshtojë hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, duke sugjeruar ndryshimet përkatëse. Në rast të kundërt kjo rregullore konsiderohet si e pranuar nga Asambleja. Sa i përket rregulloreve

Drejtuar
Kosovës
A. K.



të tjera të organizimit të brendshëm të shoqërisë, nuk bëhet paraqitja e tyre para Asamblesë së Përgjithshme, por ato miratohen drejtpërdrejtë nga Administratori.

KREU IV

VITI FINANCIAR, EKSPERTËT, PËRCAKTIMI I FITIMIT

Neni 14 VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 15 LLOGARITË FINANCIARE DHE EKSPERTËT

1. Administratori do të mbajë llogari adekuate dhe do të përgatisë raporte financiare për të reflektuar me kujdes kushtet financiare të shoqërisë në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë e raportet financiare do të jenë në formë e në detaje dhe në përputhje me standartet e kontabilitetit sipas parashikimit që bën ligji.
2. Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm, të cilët do të kenë këto përgjegjësi :
 - Kontrollon të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Aksionareve.
 - Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë Asamblesë së Përgjithshme për ta shqyrtuar e miratuar mbi bazën e së drejtës vendimore që ka.
 - Informon me shkrim Administratorin dhe Asamblenë e Përgjithshme mbi çdo parregullsi ose mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve ose llogarive financiare të shoqërisë, që mund të rezultojnë në humbje materiale për shoqërinë.
 - Të rishikojë përshtatshmërinë e auditimeve dhe praktikave e procedurave të brendshme të kontrollit dhe nëse është me vend të bëjë rekomandime për përmirësimin e tyre;
 - Të kryejë të gjithë detyrat e përcaktuara në *ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*.

Neni 16 REZULTATI I USHTRIMIT DHE PËRCAKTIMI I FITIMIT

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 (pesë) % për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit.

Drejtuar
Kryetari
Abdullah Salla



3. Ajo (heqja) rifillon, kur për një arsye të çfarëdoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur në 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
4. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas parashikimit të nenit 10 të këtij Statuti.

KREU V

PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 17

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

1. Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
 - a) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme,
 - b) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) Nëse nuk kryhet veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) Me vendim të gjykatës.
2. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 ose disa likuidatorë duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 18

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI – NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sipas ndryshimeve që do të pësojë në kohë.

KREU VI

TË NDRYSHME

Neni 19

BAZA LIGJORE

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me të gjithë dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit:
- ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
3. Ky Statut hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes.

*Dr. Et'hem
Kosovaj
Salla*





MIRATOI
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Siper marrjes



MINISTËR
Ariben Ahmetaj

Dt 10-11-2014